

Ekonomia e eurozonës, sipas të dhënave preliminare, në TM1 2018 është karakterizuar me një rritje afërsisht të ngjashme me vitin 2017 (rreth 2.5 përqind) përderisa inflacioni vazhdon të jetë nën objektivin e BQE-së përkundër rritjes së theksuar që pësoi krahasuar me vitet paraprake (1.2 përqind).

Përforcimi i kërkesës në eurozonë është reflektuar pozitivisht në zhvillimet ekonomike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat u karakterizuan me rritje të aktivitetit ekonomik përgjatë vitit 2017.

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2018, çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare janë rritur kundrejt tremujorit të kaluar dhe kundrejt gjithë vitit 2017, kryesisht si rezultat i ndryshimit të dinamikave në ofertën dhe kërkesën në treg me rritjen e tensioneve gjeopolitike në vende të ndryshme.

Sipas të dhënave më të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në tremujorin e katërt të vitit 2017 shënoi një rritje vjetore prej 3.2 përqind, rritje e mbështetur kryesisht nga përmirësimi i pozicionit të neto eksporteve dhe pozicionit të investimeve. Në mungesë të të dhënave zyrtare nga ASK-ja për BPV-në reale për tremujorin e parë të vitit 2018, mbështetur nga tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, rritja ekonomike tremujore pritet të jetë më e lartë, kryesisht si rezultat i efektit bazë dhe përmirësimit të ecurisë së konsumit privat dhe shpenzimeve qeveritare (veçanërisht ato rrjedhëse).

Gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017, çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare, me përjashtim të ushqimeve, kanë vazhduar ecurinë e tyre rritëse me të cilën janë karakterizuar gjatë gjithë vitit 2017.

Niveli i çmimeve të konsumit në ekonominë e vendit është stabilizuar në 0.0 përqind në TM1 2018, pas ngadalësimit

me të cilën u karakterizuan që nga gjysma e dytë e vitit 2017. Në anën tjetër, inflacioni bazë (që përjashton ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin), në TM1 2018 rezultoi lehtësisht më i lartë kundrejt inflacionit të përgjithshëm në 0.1 përqind, kryesisht si rezultat i rënies së çmimeve të energjisë.

Spektori fiskal u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore prej 6.7 përkatësisht 20.2 përqind. Duke pasur parasysh rritjen më të lartë të shpenzimeve krahasuar me të hyrat, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 38.6 milionë euro (5.9 milionë euro suficit në TM1 2017). Borxhi publik në TM1 2018 ka arritur në mbi 1.0 miliardë euro, që është për 9.1 përqind më i lartë krahasuar me vitin TM1 2017. Rritja e borxhit publik në Kosovë i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm përderisa borxhi i jashtëm publik u karakterizua me rënie.

Gjatë TM1 2018, sektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 6.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ky përmirësim i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve, të ardhurave parësore dhe dytësore ndërsa deficitit mallrave shënoi rritje. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat u karakterizuan me rritje prej 4.3 përqind përderisa Investimet e Huaja Direkte (IHD) shënuan rënie të lehtë prej 1.0 përqind.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE -----	i
Eurozona dhe Ballkani Perëndimor -----	03
Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare -----	05
Ekonomia e Kosovës -----	06
Sektori Real-----	06
Çmimet-----	08
Regjistri i bizneseve-----	10
Sektori Fiskal-----	11
Sektori i Jashtëm-----	12

FIGURAT DHE TABELAT

Figura 1. Zhvillimet makroekonomike në eurozonë -----	03
Figura 2. Normat kryesore të interesit në eurozonë-----	04
Figura 3. Çmimi i naftës 'Brent' -----	05
Figura 4. Çmimet e metaleve-----	06
Figura 5. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë-----	07
Figura 6. Konsumi privat dhe burimet e financimit -----	08
Figura 7. Treguesit e tërthortë për investimet private-----	08
Figura 8. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë -----	09
Figura 9. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë -----	09
Figura 10. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit -----	09
Figura 11. Lëvizja e çmimeve të importit -----	10
Figura 12. Lëvizja e çmimeve të prodhimit -----	10
Figura 13. Regjistri i bizneseve -----	10
Figura 14. Struktura e ndërmarrjeve të reja -----	11
Figura 15. Eksporti dhe importi i mallrave -----	12
Figura 16. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	13
Figura 17. Struktura e importeve sipas kategorive -----	13
Figura 18. Remitencat-----	14
Figura 19. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve -----	14
Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së -----	05
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	16

SHKURTESAT:


APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
WEO	World Economic Outlook

Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Sipas të dhënave preliminare të Agjencisë Statistike të Bashkimit Evropian, në tremujorin e parë të vitit 2018 ekonomia e eurozonës shënoi një rritje vjetore të ngjashme me atë të vitit 2017, rreth 2.5 përqind (Figura 1). Krahasuar me tremujorin e katërt të 2017-ës, ekonomia e Eurozonës shënoi një rritje më të dobët se niveli i parashikuar, rreth 0.4 përqind, si rezultat i goditjeve të natyrës afatshkurtër. Rrjedhimisht, pritjet për ecurinë e aktivitetit ekonomik në Eurozonë për tremujorët e tjerë të 2018-ës janë optimiste, të cilat mbështeten edhe nga përmirësimi i treguesve të punësimit dhe nga vlera të larta të indekseve të besueshmërisë së bizneseve dhe të individëve. Sipas projeksioneve të Bankës Qendrore Evropiane (BQE), në tre vitet e ardhshme, eurozona pritet të karakterizohet me rritje të qëndrueshme ekonomike. Projektioni për rritjen e BPV-së reale në eurozonë për vitin 2018 është rishikuar për lartë, në vlerën 2.4 përqind.

Në linjë me ecurinë e aktivitetit ekonomik në eurozonë, zhvillimet e përgjithshme në çmime tregojnë për presione të dobëta inflacioniste në fillim të vitit 2018. Në tremujorin e parë të këtij viti, Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve në eurozonë qëndroi nën objektivin e BQE-së në 1.2 përqind (figura 1). Inflacioni në Eurozonë pritet të shënojë vlerën mesatare prej 1.4 përqind në vitet 2018 dhe 2019, ndërkohë që presionet negative që vijnë nga ecuria e nënkomponentëve të energjisë do të kompensojnë forcimin e inflacionit bazë. Në vitin 2020, inflacioni pritet të konvergjojë drejt objektivit


të Bankës Qendrore Evropiane, duke arritur afërsisht vlerën 1.7 përqind.



Në janar dhe në mars të vitit 2018, Këshilli Mbikëqyrës i BQE-së vendosi t'i mbajë të pandryshuara normën e interesit të operacioneve kryesore të refinancimit (0.0 përqind), normën e interesit mbi lehtësirat kreditore (0.25 përqind) dhe depozitare (-0.40 përqind) (figura 2). BQE-ja pritet të vazhdojë të mbajë normën e interesit në operacionet kryesore të refinancimit të pandryshuar edhe përtej përfundimit të programit të lehtësimit sasior. Sa i përket politikave jo-konvencionale, Këshilli Mbikëqyrës i BQE-së ka konfirmuar se programi për blerje të aseteve do të vazhdojë me të njëjtin ritëm, 30 miliardë euro në muaj, deri në shtator 2018, apo edhe më tutje në rast të nevojës. Normat e kreditimit ndër-bankar Euribor 1 muaj dhe 12 muaj vazhdojnë të jenë në territor negativ rreth vlerës (-0.37 përqind dhe -0.19 përqind, respektivisht) (figura 2), dhe pritet të vazhdojnë të qëndrojnë negative edhe gjatë vitit 2018 dhe 2019. Ndërsa, yield-i i obligacioneve qeveritare dhjetëvjeçare të eurozonës ka shënuar një rritje të lehtë gjatë tremujorit të parë të vitit 2018,

rreth nivelit 1.15 përqind. Projektionet e BQE-së tregojnë për një rritje graduale të yield-it dhjetëvjeçar në nivelin 1.3 përqind dhe 1.6 përqind për vitet 2018 dhe 2019, respektivisht.

Figura 2. Normat kryesore të interesit në Zonën Euro



Burimi: BQE (2018)

Aktiviteti kreditues në eurozonë ka shënuar përmirësim të lehtë në tremujorin e parë të vitit 2018. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së kredive akorduar ekonomive familjare, të cilat kanë shënuar një rritje vjetore prej 3 përqind. Ndërsa, rritja e kredisë për ndërmarrjet ka qenë negative, rreth -0.6 përqind në terma vjetorë. Ngjashëm me ecurinë e kreditimit, janë zhvilluar edhe dinamikat e depozitave në sistemin bankar. Në tremujorin e fundit të vitit 2017, depozitat u rritën me rreth 1.6 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së kursimeve të ndërmarrjeve.

Aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë TM4 2017 kryesisht është luhatur rreth vlerës mesatare të shënuar në tre tremujorët e parë të vitit (tabela 1). Maqedonia dhe Serbia janë të vetmet vende në rajon që kanë shënuar rritje më të theksuar në tremujorin e fundit, me rreth 1.2 dhe 2.5 përqind, respektivisht. Përmirësimi i aktivitetit ekonomik në

Maqedoni është rezultat i tejkalimit të ngërçit politik të tej zgjatur, gjë e cila ka kontribuar në uljen e reduktimit të pasigurive për të ardhmen. Ndërsa në Serbi, rritja ekonomike në tremujorin e katërt të 2017-ës është udhëhequr nga performanca e mirë e sektorit të ndërtimit dhe e sektorit të tregtisë me pakicë dhe shumicë. Ndryshe nga Maqedonia dhe Serbia, rritja ekonomike në Shqipëri u ngadalësua në tremujorin e fundit të vitit, duke u luhatur rreth vlerës 3.4 përqind si rezultat i ndikimit negativ të konsumit publik dhe eksporteve neto. Ndërsa, rritja ekonomike në Malin e Zi dhe në Bosnjë dhe Hercegovinë ka shënuar vlerën 4.0 dhe 3.0 përqind, respektivisht.

Në tremujorin e parë të vitit 2018, ecuria e inflacionit ka qenë e ndryshme ndërmjet vendeve të rajonit. Serbia dhe Bosnja dhe Hercegovina kanë shënuar norma më të ulëta rritje krahasuar me mesataren e vitit 2017. Ndërsa Mali i Zi ka regjistruar normë mesatare të inflacionit rreth 3.7 përqind, duke qëndruar 1 pikë përqindje më lartë se vlera e regjistruar gjatë vitit 2017, për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë dhe të një sërë tatimesh në kuadër të rregullimit fiskal. Në Shqipëri, inflacioni mesatar në tremujorin e parë shënoi vlerën 1.9 përqind, duke qëndruar lehtësisht mbi vlerën e tremujorit paraardhës. Presionet e brendshme pozitive mbi inflacion, gjatë këtij tremujori, janë balancuar nga mbiçmimi i fortë i kursit të këmbimit.

Sa i përket zhvillimeve të sektorin bankar, tendencat e rritjes së kredive dhe depozitave kanë qenë të ndryshme ndërmjet vendeve të rajonit. Në tremujorin e parë të vitit 2018, Shqipëria dhe Serbia kanë shënuar normë të ultë të rritjes së kreditimit dhe

depozitave kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit 2017. Ndërsa, tre vendet e tjera, (Maqedonia, Mali i Zi dhe Bosnja dhe Hercegovina) kanë shënuar përmirësime përkritazi me aktivitetin kreditues dhe rritjes së depozitave.

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2015	2016	2017 T1	2017 T2	2017T3	2017T4
Bosnja dhe Hercegovina	3.0	3.2	3.4	2.8	3.0	3.0
Kosova	4.1	4.1	2.8	4.4	4.4	3.2
Mali i Zi	3.4	2.9	3.1	5.2	4.7	4.0
Maqedonia	3.8	2.9	0.0	-1.3	0.2	1.2
Serbia	0.8	2.8	1.2	1.5	2.2	2.5
Shqipëria	2.2	3.4	4.0	4.4	3.6	3.4

Burimi: Zyrat Kombëtare Statistikore të vendeve përkatëse

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2018, euro është vlerësuar me rreth 0.2 përqind krahasuar me shportën e monedhave të partnerëve kryesorë tregtarë të Kosovës. Kontribut në këtë vlerësim të monedhës euro kanë patur dollari amerikan (15.5 përqind), franka zviceriane (8.9 përqind) dhe lira turke (19.2 përqind). Ndërsa ndaj lekut shqiptar dhe dinarit serb, monedha euro është zhvlerësuar me rreth 2.5 përqind dhe 4.4 përqind, respektivisht.


Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2018, çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare janë rritur krahasuar me tremujorin e kaluar dhe me gjithë vitin 2017, si rezultat i faktorëve të kërkesës dhe ofertës apo si rezultat i tensioneve gjeopolitike në vende të ndryshme.

Çmimet e naftës së papërpunuar u rritën me 10 përqind në terma tremujorë, duke shënuar vlera dyfish më të larta se ato të regjistruara në fillim të vitit 2016. Rritja më e fortë e konsumit të naftës dhe

dakordësia më e madhe seç pritej ndërmjet prodhuesve të OPEC-ut dhe atyre jashtë OPEC-ut për reduktime të prodhimit të naftës kanë çuar në uljen e gjendjes së inventarit në 30 milionë fuçi mbi mesataren 5-vjeçare. Gjithashtu, tensionet në rritje gjeopolitike, si vendosja e barrierave ndaj Iranit nga SHBA, përshkallëzimi ushtarak në Siri dhe përkeqësimi i tensioneve ndërmjet Iranit dhe Arabisë Sauditë kanë rrezikuar eksportet e naftës. Në tremujorin e parë të vitit 2018, çmimi i naftës *Brent* ka shënuar vlerën 64 dollarë për fuçi, dukë shënuar rritje prej 23 përqind nga mesatarja e shënuar në vitin 2017 (54 dollarë për fuçi).

Figura 3. Çmimi i naftës 'Brent'




Burimi: Banka Botërore (2018)

Gjatë viteve 2018 dhe 2019, çmimet e naftës së papërpunuar pritet të luhaten mesatarisht rreth vlerës 65 dollarë për fuçi. Megjithatë, ecuria e çmimeve të naftës në të ardhmen varet në mënyrë të konsiderueshme nga balanca ndërmjet prodhimit të naftës në SHBA dhe persistencës në uljen e prodhimit të naftës nga OPEC-u (figura 3).

Indeksi i çmimeve të metalit dhe të mineraleve në terma tremujorë u rrit me rreth 4 përqind, që përfaqëson një normë më të moderuar se ajo e

regjistruar në vitin 2017 (rreth 24 përqind), si rezultat i kërkesës së fortë në terma globalë dhe “ngërçeve” të ndryshme nga ana e ofertës. Gjatë vitit 2018, çmimet e metalit priten të rriten me 9 përqind. Rritja e çmimit të metalit të hekurit pritet të shënojë rënie me rreth 11 përqind për shkak të ofertës së lartë, e cila do të kompensohet nga rritja e çmimeve të të gjitha metaleve të tjera bazë, veçanërisht e nikelit. Gjithashtu, në të ardhmen ekonomia e Kinës do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në tregjet globale të metaleve, duke qenë se përbën rreth 50% të konsumit të metaleve në nivel global. Kina pritet të reformojë procesin e sektorit të minierave dhe të përpunimit dhe të orientohet drejt një ekonomie të bazuar në konsum, gjë e cila do të ndikojë në rritje më të ngadaltë të kërkesës për metale (figura 4).

Figura 4. Çmimet e metaleve



Burimi: Banka Botërore (2018)

Edhe çmimi i arit ka shënuar rritje në tremujorin e parë të vitit 2018 me rreth 4 dhe 9 përqind në terma tremujorë dhe vjetorë, përkatësisht, duke regjistruar vlerën 1329 dollarë për ons. Kjo rritje i atribuohet kërkesës më të fortë për investim në kushtet e dobësimit të dollarit dhe rritjes së inflacionit. Edhe pse shtrëngimi i politikës monetare nga Rezerva Federale pritet të reduktojë kërkesën për investime

për asetet që nuk kanë kthim (siç është rasti i arit), rritja e normës bazë së interesit në muajin mars ishte e pritur dhe rrjedhimisht nuk pati ndonjë ndikim në çmimin e arit. Gjatë vitit 2018, çmimi i arit pritet të rritet me rreth 3 përqind, si rezultat i rritjes së kërkesës për investim.

Në tremujorin e parë të vitit 2018, indeksi i prodhimeve bujqësore shënoi për herë të parë rritje që prej mesit të vitit 2016, duke shënuar një normë rritje prej 2.2 përqind krahasuar me tremujorin e kaluar, si rezultat i mbjelljeve të reduktuara të misrit dhe prodhimit të kufizuar në Amerikën Jugore për shkak të kushteve klimaterike. Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim, çmimet e ushqimeve priten të stabilizohen, me një tendencë të lehtë rritëse si pasojë e shtrëngimit së ofertës së tyre.

Ekonomia e Kosovës

Sektori Real


Sipas të dhënave më të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në tremujorin e katërt të vitit 2017 shënoi një rritje vjetore prej 3.2 përqind. Kontributi kryesor në këtë rritje ka ardhur nga eksportet neto (mallra dhe shërbime) dhe investimet totale, me rreth 1.46 pikë përqindje dhe 1.10 pikë përqindje, respektivisht (figura 5). Kontributi pozitiv në rritje i eksporteve neto këtë tremujor krahasuar me tremujorin e vitit 2016 është rezultat i rritjes së eksporteve, veçanërisht atyre të shërbimeve.

Ndërsa, konsumi privat ka patur kontribut të lehtë pozitiv në rritjen reale të BPV-së në tremujorin e katërt të 2017-ës, me rreth 0.14 pikë përqindje,

ndërkohë që ky kontribut në të njëjtën periudhë të vitit paraprak është luhatur rreth vlerës 3.15 përqind. Ky kontribut pozitiv mbështetet nga zhvillimet pozitive që janë regjistruar në burimet kryesore të financimit të konsumit privat. Në tremujorin e katërt të 2017-ës, remitencat, kompensimi i punëtorëve dhe kredia e re për konsum kanë përshpejtuar trendin e rritjes së tyre, duke shënuar rritje vjetore prej 10, 15 përkatësisht 60 përqind. Ndërkohë vlera më e ulët kontributit të konsumit privat në tremujorin e katërt të 2017 ndaj tremujorit të njëjtë të vitit 2016 i atribuohet kryesisht rritjes më të ngadaltë të importeve të mallrave të konsumit (figura 6).

Kontributi pozitiv i investimeve totale i atribuohet kryesisht investimeve private, duke marrë në konsideratë se investimet publike gjatë tremujorit të katërt të 2017 kanë shënuar rënie prej 9 përqind në terma vjetorë.

Figura 5. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë



Sipas metodës së prodhimit, kontributin më të madh në rritjen e BPV-së reale në tremujorin e katërt të vitit 2017 e kishte industria përpunuese (1.05 pikë përqindje), tregtia me shumicë e pakicë dhe riparimi i automjeteve e motoçikletave (0.95 pikë përqindje) dhe

aktivitetet financiare dhe të sigurimit (0.97 pikë përqindje). Ndërsa, kategoria “shërbime të tjera” ka patur kontributin më të madh negativ (2.2 pikë përqindje) në rritjen e BPV-së reale.


Për gjithë periudhën janar-shtator 2017, ekonomia e Kosovës ka shënuar një rritje reale mesatarisht rreth 3.9 përqind, duke qëndruar lehtësisht poshtë rritjes mesatare të shënuar në vitin 2016 (rreth 4.1 përqind).

Edhe pse të dhënat zyrtare nga ASK-ja për BPV-në reale në tremujorin e parë të 2018-ës nuk janë ende të disponueshme, mbështetur nga tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, rritja ekonomike në këtë tremujor kundrejt tremujorit të njëjtë në vitin paraprak pritet të jetë më e lartë, kryesisht si rezultat i efektit bazë dhe përmirësimit të ecurisë së konsumit privat dhe shpenzimeve qeveritare (veçanërisht ato rrjedhëse).

Eksportet neto janë përkeqësuar në dy muajt e parë të vitit 2018, duke zgjeruar bilancin e tyre negativ me rreth 26% përqind. Shpenzimet kapitale në muajt janar dhe shkurt të vitit 2018 kanë shënuar rritje prej 9 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërkohë që shpenzimet rrjedhëse të qeverisë janë rritur me 12 përqind.

Përsa i përket ecurisë së konsumit privat në tremujorin e parë të vitit 2018, burimet kryesore të financimit japin sinjale pozitive (figura 6). Importi i mallrave të konsumit është rritur me 1.7 përqind në terma vjetorë gjatë këtij tremujori. Gjithashtu, remitencat, kompensimi i punëtorëve dhe kredia e re për konsum kanë ruajtur trendin e rritjes së tyre, duke shënuar rritje vjetore prej 9, 27 përkatësisht 52 përqind.


Figura 6. Konsumi privat dhe burimet e financimit



Burimi: ASK (2018) dhe llogaritje të BQK-së

Treguesit e tërthortë për investimet private ofrojnë sinjale negative në tremujorin e parë të vitit 2018. Investimet e huaja direkte dhe kreditë e reja për investim kanë shënuar norma rritje të moderuara, rreth 7.9 përqind dhe 29 përqind, respektivisht, krahasuar me tremujorin e vitit paraardhës. Ndërsa, importi i mallrave kapitale ka shënuar rënie prej 0.5 përqind. Gjithashtu, numri i bizneseve të reja, korrigjuar me numrin e bizneseve të mbyllura, ka regjistruar rënie prej 13 përqind.

Figura 7. Treguesit e tërthortë për investimet private



Burimi: ASK (2017) dhe llogaritje të BQK-së

Sipas projeksioneve të BQK-së, aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2018 do të shënojë një përmirësim të lehtë krahasuar me të dhënat aktuale të vitit 2017, duke u

luhatur në një interval prej 4.2 përqind në 4.4 përqind. Ky përmirësim i lehtë i atribuohet stimulit të përforcuar fiskal gjatë vitit 2018, veçanërisht ai i gjeneruar nga shpenzimet kapitale të qeverisë. Remitançat dhe aktiviteti kredihënës, edhe gjatë vitit 2018, do të vazhdojnë të jenë burime të qëndrueshme për financimin e aktivitetit ekonomik. Ambienti i jashtëm do të jetë favorizues për bilancin tregtar, si rezultat i rritjes më të ngadaltë të çmimeve të mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare dhe një rishikim për lartë të aktivitetit ekonomik në vendet partnere tregtare të Kosovës.


Në tremujorin e katërt të vitit 2017, shkalla e punësimit u rrit lehtësisht në 29.8 përqind krahasuar me vlerën 29.5 përqind në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Pavarësisht kësaj, norma e papunësisë u luhet rreth vlerës 30.6 përqind në tremujorin e katërt të vitit 2017 ndërkohë që në tremujorin e fundit të vitit 2016 kjo normë regjistroi një vlerë më të ulët, rreth 28.7 përqind. Arsyeja pse rritja e shkallës së punësimit nuk është reflektuar në reduktimin e normës së papunësisë qëndron në rritjen e shkallës së pjesëmarrjes në fuqinë punëtore në vlerën 42.9 përqind në fund të vitit 2017 krahasuar me shkallën prej 41.3 përqind në fund të vitit 2016. Tendencat e treguesve kryesorë të punës të shënuar gjatë tremujorit të katërt janë të njëjta me zhvillimet e regjistruara gjatë gjithë vitit 2017.

Çmimet

Ndryshimi i indeksit të çmimeve të konsumit i cili ka filluar të shënojë rritje më të ngadalësuar duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2017, tani është stabilizuar

dhe në TM1 2018 norma e rritjes së çmimeve ishte 0.0 përqind (figura 8).


Figura 8. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2018)

Sa i përket komponentëve të IÇK-së, gjatë TM1 2018, me rritje u karakterizuan çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit (1.7 përqind), pasuar nga çmimet e transportit (1.0 përqind), çmimet e ushqimit dhe pijeve jo-alkoolike (0.6 përqind), etj.

Figura 9. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2018)


Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar tek çmimet e strehimit, ujit, rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse (5.0 përqind), kryesisht për shkak të modifikimit të tarifave të energjisë elektrike në prill të vitit 2017. Rënie është shënuar edhe tek çmimet e

rekreacionit dhe kulturës (1.6 përqind) si dhe tek çmimet e veshmbathjes (0.7 përqind) (figura 9).

Siç shihet në figurën 8, inflacioni bazë i cili përjashton ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin, ka qenë më stabil se sa lëvizja e inflacionit të përgjithshëm gjatë vitit 2017 ndërkohë që në TM1 2018 inflacioni bazë (0.1 përqind) ishte paksa më i lartë krahasuar me inflacionin e përgjithshëm.

Ky dallim i inflacionit bazë me inflacionin e përgjithshëm është rezultat i pjesëmarrjes shumë të lartë që e kanë në shportën e konsumatorit kosovarë produktet që karakterizohen me lëvizje sezonale të çmimeve (ushqimi, energjia, pijet alkoolike dhe duhani) por edhe për shkak se lëvizja e këtyre çmimeve ka qenë më e theksuar.


Figura 10. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit



Burimi: ASK (2018)

Dinamika që e ka përcjellë nivelin e çmimeve në Kosovë gjatë vitit 2017 përgjithësisht dhe tremujorit të katërt veçanërisht, përveç rritjes së aktivitetit ekonomik i atribuohet edhe rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importi. Indeksi i çmimeve të importit në TM4 2017 shënoi rritje prej 2.5 përqind (figura 10).


Figura 11. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2018)

Çmimet e produkteve bimore, metaleve bazë dhe produkteve minerale, të cilat janë kategoritë kryesore të indeksit të çmimeve të importit, shënuan rritjen më të lartë (15.6, 12.9 përkatësisht 7.4 përqind), ndërsa çmimet e letrës dhe artikujt e saj si dhe çmimet e lëkurës shënuan rënien më të lartë të çmimeve (10.8 përkatësisht 4.0 përqind) (figura 11).

Figura 12. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2018)


Indeksi i çmimeve të prodhimit në TM4 2017 u karakterizua me rritje prej 1.6 përqind. Në këtë periudhë, me rritje të çmimeve u karakterizuan nxjerrja e xehes së metalit, prodhimi i drurit, prodhimi i lëkurës, etj. Ndërsa, me rënie të çmimeve u

karakterizuan kryesisht prodhimi i pijeve, prodhimi i mobileve, etj. (figura 12).

Regjistri i bizneseve

Trendi i numrit më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara që e karakterizoj vitin 2017 është duke vazhduar edhe në vitin 2018. Në TM1 2018 u regjistruan 2,556 ndërmarrje të reja apo 294 ndërmarrje më pak krahasuar me TM1 2017. Përveç kësaj, në TM1 2018 janë mbyllur 482 ndërmarrje apo 37 ndërmarrje më shumë krahasuar me TM1 2017 (figura 13).


Figura 13. Regjistri i bizneseve, jo kumulative



Burimi: ASK (2018)

Sa i përket strukturës së ndërmarrjeve të reja, trendi ka vazhduar të jetë relativisht i ngjashëm me tremujorët paraprakë. Numri më i madh i ndërmarrjeve të reja të regjistruara vazhdon të jetë i koncentruar në sektorin e tregtisë me 722 ndërmarrje të reja, pasuar nga sektori i prodhimit me 316 ndërmarrje, sektori i ndërtimit me 266 ndërmarrje, etj. (figura 14).

Figura 14. Struktura e ndërmarrjeve të reja



Krahasuar me TM1 2017, në shumicën e sektorëve është shënuar numër më i vogël i ndërmarrjeve të regjistruara. Në sektorin e bujqësisë janë regjistruar 223 ndërmarrje më pak, në sektorin e tregtisë 77 ndërmarrje më pak, në sektorin e transportit 21 ndërmarrje më pak, etj. Sektorët kryesorë që shënuan numër më të madh të ndërmarrjeve të regjistruara ishin sektori i prodhimit dhe ai i aktiviteteve profesionale, ku u regjistruan 51 përkatësisht 16 ndërmarrje më shumë krahasuar me TM1 2017.

Sektori Fiskal

Gjatë TM1 2018, sektori fiskal u karakterizua me performancës të mirë të të hyrave buxhetore dhe rritje të shpenzimeve buxhetore. Të hyrat buxhetore¹ arritën vlerën prej 362.0 milionë euro apo 6.7 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja e arkëtimit të të hyrave buxhetore erdhi si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik por edhe reformave të ndërmarra nga agjencitë e të hyrave që kanë për synim ngushtimin e hendekut

¹ Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

tatimor. Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore direkte të cilat arkëtohen nga tatimi në të ardhura dhe pasuri. Këto të hyra në TM1 2018 shënuan rritje prej 26.5 përqind dhe arritën vlerën prej 72.5 milionë euro. Me rritje u karakterizuan edhe të hyrat tatimore indirekte të cilat janë të ndërlidhura me lëvizjen e importit i cili ka shënuar rritje të konsiderueshme gjatë TM1 2018. Të hyrat indirekte arritën vlerën prej 261.5 milionë euro (3.5 përqind rritje). Të hyrat jo-tatimore, që kryesisht janë të hyra nga organizatat buxhetore, shënuan rënie prej 8.3 përqind dhe arritën vlerën 41.1 milionë euro.

Në anën tjetër, shpenzimet buxhetore² arritën vlerën prej 400.7 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 20.2 përqind. Gjatë kësaj periudhe të gjitha kategoritë e shpenzimeve buxhetore u karakterizuan me rritje. Shpenzimet qeveritare për paga shënuan rritje prej 5.1 përqind dhe arritën vlerën prej 143.6 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 17.7 përqind dhe arritën vlerën prej 127.3 milionë euro. Shpenzimet qeveritare për mallra dhe shërbime (përfshihen edhe komunalitë) shënuan rritje për 20.2 përqind dhe arritën vlerën prej 48.9 milionë euro. Investimet kapitale, të cilat përfaqësojnë rreth 20.2 përqind të gjithë shpenzimeve buxhetore, shënuan rritje prej 44.0 përqind dhe arritën vlerën 80.9 milionë euro.

Duke pasur parasysh rritjen më të lartë të shpenzimeve krahasuar me të hyrat, buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor prej 38.6 milionë euro (5.9 milionë euro suficit në TM1 2017).

² Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

Borxhi publik, në TM1 2018, ka arritur në 1.0 miliardë euro që është për 9.1 përqind më i lartë krahasuar me vitin TM1 2017. Rritja e borxhit publik në Kosovë i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm prej 27.8 përqind (i cili ka arritur në 612.5 milionë euro), ndërsa borxhi i jashtëm publik ka shënuar rënie prej 10.2 përqind duke arritur në 416.0 milionë euro. Pra, pjesa më e madhe e borxhit publik (59.6 përqind) është borxh i brendshëm, që kryesisht përbëhet nga borxhi i Qeverisë së Kosovës ndaj bankave komerciale (43 përqind), institucioneve publike (33 përqind), fondeve pensionale (20 përqind), etj. Pjesa tjetër e borxhit publik (40.4 përqind) është borxh i jashtëm, që kryesisht i përket Fondi Monetar Ndërkombëtar me 38 përqind, Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim me 37 përqind, Agjencia Gjermane për Rindërtim me 13.0 përqind, etj.

Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.2 përqind nga 15.0 përqind sa ishte në TM1 2017. Përkundër rritjes, ky nivel i borxhit është ende larg pragut prej 40 përqind të paraparë me ligj. Për më tepër, ky nivel i borxhit publik e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit, të cilat sipas FMN-së, kanë një mesatare të borxhit publik prej 59.1 përqind.


Sektori i Jashtëm

Gjatë TM1 2018, sektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 6.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ky përmirësim i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilanceve

pozitive të shërbimeve, të ardhurave parësore dhe dytësore ndërsa deficitit të mallrave shënoi rritje.

Deficiti në llogarinë e mallrave shënoi vlerën prej 582.4 milionë euro në TM1 2018, që paraqet një rritje vjetore prej 9.3 përqind. Përderisa në vitin 2017 ishte shënuar rritje e theksuar e eksportit të mallrave, viti 2018 ka filluar me trend negativ. Në TM1 2018 eksportit i mallrave ka shënuar vlerën prej 73.4 milionë euro që është për 4.0 përqind më pak krahasuar me TM1 2017. Kjo rënie e eksportit të mallrave ishte për shkak të ngadalësimit të rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare por edhe për shkak të stabilizimit të kërkesës së jashtme (figura 15).³

Figura 15. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro




Burimi: ASK (2018)

Rënia e eksportit të mallrave gjatë këtij tremujori ishte më e theksuar tek metalet bazë dhe produktet minerale. Në anën tjetër, me rritje u karakterizua eksporti i produkteve të plastikës dhe gomës, eksporti i ushqimeve, eksporti i tekstilit dhe artikujve të tekstilit, etj. (figura 16).

³ Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Figura 16. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2018)


Si rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme në vend, me rritje të konsiderueshme është karakterizuar importi i mallrave. Vlera e importit të mallrave në TM1 2018 ishte 655.7 milionë euro, që është për 7.6 përqind më shumë krahasuar me TM1 2017. Rritja e importit ishte kryesisht rezultat i rritjes së importit të metaleve bazë, makinerive dhe pajisjeve mekanike, produkteve të plastikës dhe gomës, etj., ndërsa importi i ushqimeve të përgatitura shënoi rënie (figura 17). Në TM1 2018, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte ishte 11.2 përqind (12.5 përqind në TM1 2017).

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 82.9 milionë euro, një rritje prej 36.3 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoi rritje vjetore prej 23.2 përqind, duke arritur në 194.7 milionë euro, ndërsa vlera e shërbimeve të importuara shënoi rritje prej 15.0 përqind dhe arriti në 111.8 milionë euro.

Në kuadër të eksportit të shërbimeve, shërbimet e udhëtimit përbëjnë kategorinë kryesore (67.0 përqind e gjithsej eksportit të shërbimeve) dhe shënuan rritje

prej 21.9 përqind. Sa i përket importit të shërbimeve, shërbimet e biznesit dhe shërbimet e udhëtimit shënuan rritjen më të lartë, ndërsa shërbimet kompjuterike shënuan rënie.

Figura 17. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje




Burimi: ASK (2018)

Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore shënoi vlerën prej 26.4 milionë euro (15.5 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2017). Bilanci i të ardhurave nga kompensimi i punonjësve⁴ shënoi rritje për 17.9 përqind, ndërsa bilanci i të ardhurave nga investimet u zvogëlua për 6.7 përqind. Në të njëjtën periudhë, bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 8.9 përqind, që i atribuohet nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore arritën vlerën prej 170.4 milionë euro dhe shënuan një rritje vjetore prej 4.3 përqind (figura 18).

⁴ Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qëndrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

Figura 18. Remitencat, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

Rritja e remitencave mund t'i atribuohet, deri në një masë, rritjes së aktivitetit ekonomik në Eurozonë dhe Zvicër, duke qenë se remitencat që pranohen në Kosovë vijnë kryesisht nga Gjermania dhe Zvicra. Remitencat që pranohen nga këto dy vende kanë një pjesëmarrje prej 39.3 përkatësisht 22.5 përqind në gjithsej remitencat. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 7.0 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë.


Llogaria financiare në TM1 2018 shënoi bilanc prej 61.6 milionë euro (103.1 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit paraprak). Detyrimet por edhe asetet shënuan nivel dukshëm më të ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Detyrimet shënuan vlerën prej 39.3 milionë euro (161.1 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2017) ndërsa asetet shënuan vlerën prej -22.3 milionë euro (58.0 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2017).

Në kuadër të detyrimeve, kategoria kryesore ishin Investimet e Huaja Direkte (IHD), të cilat arritën vlerën prej 64.4 milionë euro dhe shënuan një rënie vjetore prej 1.0 përqind. Në kuadër të strukturës së

IHD-ve, me rritje u karakterizua kapitali dhe fondi i investimeve në aksione, ndërsa investimet në instrumente të borxhit shënuan rënie (figura 19).

Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione arriti vlerën prej 80.1 milionë euro dhe shënoi rritje prej 41.4 përqind. IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerë negative prej 15.6 milionë euro (8.4 milionë euro në TM1 2017).

Figura 19. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

Rënia më lartë e IHD-ve u shënuar në sektorin e shërbimeve financiare dhe të ndërtimtarisë (5.9 përkatësisht 3.4 milionë euro) përderisa në patundshmëri dhe në sektorin e tregtisë u shënuar rritje e IHD-ve (2.1 përkatësisht 2.0 milionë euro më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar). Sa i përket origjinës së IHD-ve, Gjermania paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në TM1 2018 (17.4 milionë euro), pasuar nga Zvicra me 15.4 milionë euro, Austria me 8.4 milionë euro, etj.

Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:

BQK (2018): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 22 TM1 2018, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

Referencat:

BQK (2018):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2018):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-
- c) Indeksi i çmimeve të importit: http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2018): Metal Prices database.

FAOUN (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations:
<http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2018): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2018): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>

Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	TM1 2017	TM1 2018
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	1,247.5	-
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	1.6%	0.0%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	1.5%	0.1%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	339.3	362.0
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	333.4	400.7
Bilanci primar (në milionë euro)	5.9	-38.6
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,508.8	5,906.3
prej të cilave: Bankat	3,669.8	3,872.9
Kredi	2,294.9	2,534.3
Depozita	2,911.6	3,074.0
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	7.0%	6.8%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	0.9%	1.2%
Hendeku i normës së interesit	6.1%	5.6%
Sektori i jashtëm, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-172.2	-165.1
prej të cilave: remitencat e pranuar	163.4	170.4
Llogaria financiare	-103.1	-61.6
Investimet e huaj direkte në Kosovë	65.1	64.4
Investimet portfolio, net	-26.1	-21.8
Investimet tjera, net	-94.8	-144.4
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net*	-81.0	-120.1
Asetet	4,547.7	4,824.4
Detyrimet	4,628.7	4,944.4
Borxhi i jashtëm, gjithsej	2,015.1	2,091.6
Borxhi i jashtëm privat	1,570.5	1,598.3
Borxhi i jashtëm publik	444.6	493.3

Burimi:

1/ ASK (2018).

2/ MF (2018).

3/ BQK (2018).

*Të dhënat për PNI dhe borxh të jashtëm janë të fund vitit 2017 përkatësisht 2016.

